REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr.2500.Prot. **Vlorë, më 29.09.2026**

VENDIM
Nr.12, datë 25.09.2026

PËR MIRATIMIN E 3 LINJAVE TË TRANSPORTIT RRETHQYTETËS PËR BASHKINË FINIQ

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 25.09.2026, mbështetur në Ligjin Nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligjin Nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore" i ndryshuar, Udhëzimit Nr. 15, datë 24.07.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të liçencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor" i ndryshuar si dhe kërkesës së Bashkisë Finiq me Nr. 2913, datë 21.08.2026.

VENDOSI:

1. Të miratojë linjat:

   Cerkovicë - Shëndre - Dhivër - Memoraq – Fitore – Ardhasovë – Tremul – Rrahullë – Aliko – Çaush – Sarandë (dhe kthim)
   Nisja në orën 08:00 dhe kthimi në orën 14:00 (1 rrugë në javë)

   Muzinë – Krongj – Bistricë – Mesopotam – Kranë – Sarandë (dhe kthim)
   Nisja në orën 08:00 dhe kthimi në orën 14:00 (1 rrugë në javë)

   Vagalat – Dobro – Livadhja – Kulluricë – Pllakë – Sarandë (dhe kthim)
   Nisja në orën 08:00 dhe kthimi në orën 14:00 (1 rrugë në javë)

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij Vendimi Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social pranë Këshillit të Qarkut Vlorë

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit Nr. 139/2015 dt.17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 78, pika 3.

Sekretar i Këshillit të Qarkut
Vllasi Nasaj

KRYETAR
Ervis Moçka
(nënshkruar dhe vulosur)

Specialist i Shërbimeve
Palush Naçi

Jurist
Alma Myrtaj

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" , Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail:info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

RELACION

"PËR MIRATIMIN E 3 (TRE) LINJAVE TË TRANSPORTIT RRETHQYTETËS PËR BASHKINË FINIQ"

Të nderuar Këshilltarë,

Në mbështetje të *Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar,* si dhe *Udhëzimit nr. 15, datë 24.07.2007, "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor", i ndryshuar,* si dhe në kuadër të ushtrimit të kompetencave të Këshillit të Qarkut Vlorë në fushën e transportit rrugor, si dhe me qëllim garantimin dhe përmirësimin e shërbimit të transportit të udhëtarëve për banorët e Bashkisë Finiq, është paraqitur kërkesa e Bashkisë Finiq me Nr. 2913 Prot, datë 21.08.2026, me lëndë "Kërkesë për miratimin e 3 (tre) linjave të transportit rrethqytetës, protokolluar me tonën Nr 2170 Prot, datë 26.08.2026.

Nga shqyrtimi i kërkesës rezulton nevoja për krijimin e lidhjeve të rregullta të zonave dhe fshatrave të Bashkisë Finiq me qytetin e Sarandës, duke lehtësuar lëvizjen e banorëve për nevoja administrative, ekonomike, shëndetësore, arsimore dhe për marrjen e shërbimeve të ndryshme.

Në këtë kuadër, propozohet miratimi i këtyre linjave:

1. **Cerkovicë – Shëndre – Dhivër – Memoraq – Fitore – Ardhasovë – Tremul – Rrahullë – Aliko – Çaush – Sarandë dhe kthim,** me nisje në orën 08:00 dhe kthim në orën 14:00, **1 udhëtim në javë.**
2. **Muzinë – Krongj – Bistricë – Mesopotam – Kranë – Sarandë dhe kthim,** me nisje në orën 08:00 dhe kthim në orën 14:00, **1 udhëtim në javë.**
3. **Vagalat – Dobro – Livadhja – Kulluricë – Pllakë – Sarandë dhe kthim,** me nisje në orën 08:00 dhe kthim në orën 14:00, **1 udhëtim në javë.**

Sa më sipër, kërkojmë shqyrtimin dhe miratimin e projektvendimit "Për miratimin e 3 (tre) linjave të transportit rrethqytetës për Bashkinë Finiq".

Ju Faleminderit!

Specialisti i Shërbimeve, Transportit dhe Emergjencave Civile

Palush Naçi

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" , Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail:info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600